


## Përmbledhje – Jo Teknike

**Aktiviteti: “ Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme” të  
Subjektit Ramazan TATANI P/F.**

**Objekti gjendet në Tirane Synej Rrakull Fshati Rrakull, rruga  
Karpen,objekt 1-katesh, zona kadastrale nr.3204, pasuria nr.34/27.**



**Aktiviteti:** Rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme.

**Subjekti:** Ramazan TATANI P/F.

**Investitori:** Ramazan TATANI

**Vendndodhja:** Objekti gjendet në Tirane Synej Rrakull Fshati Rrakull, rruga  
Karpen,objekt 1-katesh, zona kadastrale nr.3204, pasuria nr.34/27.

## **Përshkrimi i instalimit.**

Aktiviteti Ramazan TATANI P/F me Administrator Z.Ramazan Tatani, vendosi të fillojë këtë aktivitet pasi trualli është në pronësi të tij, i cili do të shërbej si shesh ndërtimi për Linjen e fraksionimi të mbetjeve inerte të dalta nga prishje e ndertimeve dhe rrugeve. Subjekti ka marrë nismën për të ulur nivelin e mbetjeve që krijohen nga veprat e ndertimeve si dhe të shkatërrimeve për arsye të rikonstruksioneve të ndryshme. Subjekti kërkon që të rikuperojë mbetjet e ngurta me anë të linje të thjeshtë të fraksionimit. Shoqëria ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj germime transportim dhe tregtim inertesh.

Në mënyrë të përmbledhur **të dhënat e kësaj linje për rikuperimin e mbetjeve jo të rrezikshme(inerte)** përmbledhen si më poshtë:

Sipërfaqja totale e objektit	2225 m <sup>2</sup>
Kapaciteti i inplantit	20 m <sup>3</sup> / ore

Cikli i punës do të jetë **me një ndërresë 8 orë/ditë** dhe parashikohet të punohet rreth **264 ditë/vit.**

Aktiviteti Ramazan Tatani P/F vendosi të fillojë këtë aktivitet në këtë zonë pasi:

### **Vendi i zgjedhur ka këto përparësi:**

- Trualli ku ushtrohet aktiviteti është në pronësi të familjes.
- Ndodhet jashtë zonës së banuar dhe vijave të verdha
- Nuk ka probleme sociale e mjedisore
- Ka infrastrukture pothuaj të gatshme

### **Kufizimet e objektit**

Nga veriu kufizohet me	Rruga hyrëse.
Nga Jugu kufizohet me	prone private.
Nga lindja kufizohet me	prone private.
Nga perëndimi kufizohet me	prone private.

## Vendodhja e projektit.

## Ortofoto e veprimtarisë.



## Kordinatat e aktivitetit.

Nr	X	Y
1	4375192.47	4563338.24
2	4375218.55	4563340.47
3	4375305.25	4563233.04
4	4375284.36	4563218.72

## Proçesi i punës:

Proceset kryesore te punes jane:

- Sigurimi i lendes se pare(mbetje nga shkaterrimi i objekteve te ndyshme dhe mbetje asfatobetoni)
- Magazinimi i lendes se pare
- Thyerje dhe bluarje e lendes se pare
- Magazinimi i materialit inert te perftuar nga trajtimi i mbetjes

IMPIANTI I FRAKSIONIMIT TE INERTEVE

- Impianti i fraksionimit dhe procesi i përpunimit të materialit inert
- Bunkeri i depozitimit të materialit inert.
- Sistemi i I-re i sitave.
- Mulliri i coptimit dhe bluarjes së inerteve.
- Transmisioni kryesor i fraksioneve.
- Sistemi i sitave vibratuese.
- Njësia e bunkereve fundor të depozitimit.


Ky impiant është tepër eficient përse i takon përdorimit të energjisë, pjesë teknologjike të ndryshme të saj ndërrohen ose modifikohen me të reja dhe shpikje të reja inxhinjerie të cilat përmirësojnë eficienten dhe optimizojnë përdorimin e energjisë dhe ndikimin e tij në mjedis. Kjo linje teknologjike sipas proceseve që realizon përbëhet nga 6 njësi bazë:

Bunkeri i depozitimit të materialit inert që vjen nga bizneset private që kanë kryer një shembje shtepie apo gerryrje rruge. Bunkeri është edhe stacioni i parë i materialit inert i cili i nënshtrohet një numri të caktuar procesesh. Bunkeri i depozitimit ka formën e një hinke me fund nga sipër, një kapacitet volumetrik relativ prej 20m<sup>3</sup>, i ndërtuar prej metali me diameter fletë prej 0.8 mm bunkeri është tepër rezistent ndaj forcave mekanike. Në bunker shkarkohet materiali inerte i cili nëpërmjet forcës tërheqëse gravitacionale drejtohet në sistemin e sistemin e I -rë të sitave. Paraqitje skematike e thjeshtë e bunkerit




**Sistemi i I-re i sitave**, është një set sitash vibruese dhe mund të konceptohet si njësi e dytë funksionale e impiantit të fraksionimit. Konstruksioni i sitave është tërësisht metalik, çelik rezistent për ti rezistuar forcave të ndryshme mekanike dhe të fërkimit. Këtu realizohet një ndarje fillestare grimcore e materialit inert bruto që depozitohet në bunker, ky proces realizohet nëpërmjet nuk kërkon shpenzim të madh energjie.

Pjesa e fraksioneve që depërtojnë në këtë sistem sitash i përkasin fraksionit të rërës me dhe pasi grumbullohen në kazanin pritës së sitave transportohen nëpërmjet një rrypi të transmisioni me gjërësi 60 cm dhe depozitohen në vendin e caktuar në sheshin e kantierit.



**Mulliri i copimit dhe bluarjes së inerteve**, është njësi agragate e tretë e procesimit të materialit inert. Mulliri përbëhet nga një kazan metalik me dm fletë 1.0 mm dhe rezistent ndaj forcave mekanike. Në këtë njësi realizohet copëtimi me anë të goditjeve të ushtruar mbi materilin inert. Copëtimi i aggregateve realizohet nëpërmjet 5 çekiçëve çeliku. Në këtë njësi teknologjike përpunohet masa inerte që vjen nga sistemi i parë i sitave vibruese gjithashtu në kazanin e mullirit është montuar një sistem tubash të cilat lëshojnë ujë në formë shiu. Prej kësaj fraksionet e copëtuara grumbullohen në kazanin pritës në formë hinke që shkarkon mbi rrypin e transmisionit nr 2.

**Transmisioni kryesor i fraksioneve të dala nga mulliri bluarës**, është një rryp gome, me gjërësi 80 cm i cili mbështetet dhe në një sërë cilindrash rrotullues që lëvizin nga një elektromotor. Rrypi i transmisionit realizon zhvendosjen dhe transportin e masës së procesuar nga mulliri bluarjes për në njësinë e sistemit të II - të të sitave. Procesi i realizuar nga rrypi i transmisionit është procesi i parafundit të ciklit të plotë nëpër të cilin kalon masa e materialit inert që nga depozitimi bruto i tij në bunker deri në fazën përfundimtare të ndarjes së fraksioneve të tij nëpër bunkeret e fundit. Edhe këtu materiali inert i përpunuar është në gjendje të lagur duke mos emetuar pluhura në mjedis.



*Skema e levizjes se fraksioneve inert nga mulliri bluarjes, ne rryp transmetues, ne sitat vibruese dhe ne bunkerin e fundit te ndarjes se fraksioneve sipas diametrit granulometrik dhe ngarkimit ne automjetet e transportit.*

**Sistemi i sitave vibratuese**, realizon klasifikimin përfundimtar granulometrik i fraksioneve të materialit inert që coptohet në mulli e bluarjes. Ky sistem sitash realizon nëpërmjet një lekundje horizontale që lehtëson dhe bën të mundur qarkullimin e materialit inert, ndarjen e tij sipas fraksioneve dhe depozitimin e tij përfundimtar në bunkeret e ngarkimit të automjeteve. Sistemi i sitave vibratuese përbëhet nga sita metalike me madhësi syri që lejojnë vetëm depërtimin e fraksioneve të imta.

**Njësia e bunkereve fundor të depozitimit** përfundimtar të fraksioneve është agragati i fundit i impiantit të fraksionimit të gurit gëlqeror. Në këtë agregat i përbërë nga 5 bunkere me kapacitet vëllimor prej  $20\text{m}^3$  është realizuar përfundimisht procesi fraksionues i materialit inert. Që këtu nëpërmjet portave të shkarkimit gravitacional produkti ngarkohet në automjete transportuese.

### **Identifikimi i masave zbutese**

Nga ushtrimi i aktivitetit si Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme kemi ndikime në mjedis që janë: gjenerimi i pluhurit dhe i zhurmave, për të cilat subjekti ka marrë masa në vazhdimësi për menjanimin dhe zbutjen e tyre.

Sipërfaqja e tokës është formacion i qendrueshëm e deri me tani nuk ka të dhëna për fenomene si rreshqitja apo erozioni.

## **KONKLUZIONE**

Subjekti Ramazan TATANI P/F kerkon qe te pajiset me leje te re mjedisore Tipi B per aktivitetin Rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme per disa arsye:

Duke perdorur nje teknologji te thjeshte per realizimin e procesit te pune.

Duke kryer ndergjegjesimin e opinionit si dhe te subjekteve te interesuar per te kryer nje aktivitet te tille.

Per te ulur nivelin e perdorimit te lendeve te para ne sektorin e ndertimit.

Duke permiresuar mjedisin perreth, duke ulur nivelin e gjenerimit te mbetjeve, per te rikuperuar cdo mbetje qe mund te riperdoret


*Përgatiti*

*Raportin;*

*Green-Studio*

Ing Ervis MALAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 4935 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 361

## **ÇERTIFIKATË**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

**Z. ERVIS MALAJ**

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

**MINISTRI**

**Lefter KOKA**









REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

# LICENCË



LN-9472-04-2015	NUJS/NIPT: L51607502C
Subjekti: Ervis Malaj	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, Durres, Lagjja 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 12/02/2016	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Adresa Durres, Durres, Durres, Durres, Lagjja 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.	
Kodi: III.2.A (1+2)	
Specialiteti	
Pastrim mjedisor	
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor	
Kufizime specifike Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi	
Detyrime specifike Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi	
Vendi i kryerjes së veprimtarisë Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë	

Nënshkrimi i sportelit: JULIT TRASK



Veprimtaritë e shërbimeve mjedisore të shprehura në tabelën e mëposhtme të ligjit nr 7491